**SHOQËRIA AUDITUESE** &
*Audit, Consulting*

**ACA MARGJEKA SH.P.K.**
*Accounting Company*

SHOQERIA "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K.

# RAPORTI I SHOQËRISE AUDITUESE PER ZMADHIMIN E KAPITALIT TE SHOQERISE "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K., NEPERMES RIKAPITALIZIMIT TE FITIMEVE TE VITIT USHTRIMOR 2022 SI DHE FITIMEVE TE MBARTURA, NE ZBATIM TE VENDIMIT TE ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE .

SHOQERIA AUDITUESE "ACA MARGJEKA "SH.P.K.

AUDIT-CONSULTING ACCOUNTING
ACA MARGJEKA sh.p.k.
www.acamargjeka.com
NUIS. L61408003D TIRANE

TIRANE ME 08.10.2023

Adresa:Rr.Tre Vellezerit Kondi, Vilat Amerikane, ndertesa 736, Tirane ; Cel:+355 69 20 70 654,
www.acamargjeka.com, www.acamargjeka.al; e-mail: shkelzenmargjeka@yahoo.com

**SHOQËRIA AUDITUESE**
*Audit, Consulting*

&

**ACA MARGJEKA SH.P.K.**
*Accounting Company*

*ORTAKUT TE VETEM THEMELUES TE SHOQERISE*
"ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K. *TIRANË.*

*I nderuar Z.Gert GJELI*

Une,Shkelzen Margjeka,Auditues Ligjor, me nr. License 178 date 15.10.2008 anëtar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (www.ieka.al), partner angazhimi i shoqërise audituese "ACA MARGJEKA" sh.p.k., në zbatim të misionit të dhënë nga Juaj, në cilësinë e pronarit ( Ortakut të vetem themelues) të shoqërisë **"ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K.**, lidhur me zmadhimin e kapitalit i regjistruar të shoqërise suaj përmes rikapitalizimit të fitimeve, të legjislacionit që vepron ne Shqipëri si dhe Standarteve Nderkombetare të Auditimit paraqes raportin sa më poshtë vijon;

**Të dhënat e shoqërise.**

Shoqeria **"ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K.** është e regjistruar si shoqëri me pergjegjesi të kufizuar e regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit(QKR) me date 11/11/2009 me Nipt K92311013D.
Ortaku themelues i vetem dhe administrator i shoqërisë është z.Gert Gjeli.

**Vendndodhja dhe Objekti i veprimtarise.**

Shoqeria **"ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K.**, ka seli: Rruga "Vaso Pasha", Nr.75, Njësia Bashkiake Nr.5, Tirane, me objekt veprimtarie Agjensi mjete transporti te çdo lloji me qera, shitbletje te mjeteve te ndryshme. Agjensi Turistike, paketa turistike dhe çdo sherbim tjeter qe lidhet me kete aktivitet. Shitje bileta avioni dhe transport tjeter te çdo lloji. Pjesemarrje ne tendera te organizuar nga ente ose institucione shteterore apo private, prokurime publike. Si edhe çdo tjeter aktivitet qe ka te beje me fushen e transporteve brenda dhe jashte Shqiperise Import, eksport dhe tregtimi me shumice e pakice brenda dhe jashte vendit, per llogari te vete shoqerise, apo te treteve te materialeve te ndertimit, produkteve ushqimore dhe industriale, makinerive, pajisjeve e pjese kembimi te tyre, lendeve te para, produkteve te gatshme e gjysem te gatshme, mineraleve. Transport kombetar e nderkombetar ne rruge detare, tokesore, apo ajrore; Riparimin e makinerive te ndertimit dhe mjeteve rrugore per nevojat e shoqerise dhe te te treteve; Gjithashtu, shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje çdo lloj sherbim apo aktiviteti ndertimi, tregtar, financiar, konsulence, qiradhenes apo dorezanes, qe i lejohet nje shoqerie sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe qe i vlereson te dobishme apo te nevojshme per arritjen e qellimeve te veprimtarise se saj.Gjithashtu shoqeria mund te ndermarre dhe zhvilloje sherbim gomisterie.

**Kapitali i Regjistruar:**
Kapitali i regjistruar i shoqërisë me 31.12.2022 është 146,780,000 lekë.
**Pasqyrat financiare të shoqërisë.**
Shoqëria zbaton dispozitat e legjisacionit në fuqi,si ligji nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" i ndryshuar, ligji 25/2018 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" si dhe legjislacionin ne fuqi të detyrueshëm për tu zbatuar.
Pasqyrat financiare të shoqërise hartohen për periudhën ushtrimore Janar –Dhjetor të cdo viti ushtrimor,sic e kërkon ligji "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar.
Pasqyrat financiare të vitit 2022, pasqyrojnë gjendjen e llogarive dhe rezultatin financiar për vitin ushtrimor të mbyllur.
Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K.:
Ne përputhje me ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" i ndryshuar, ortaku i vetem themelues ka vendosur të bëjë zmadhimin e kapitalit të shoqërisë përmes përfshirjes së fitimeve në kapital.
Me 31.12.2022 shoqëria "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K., ka aktive afatshkurtra në vlere 142,750,716 lekë, të cilat përbëhen nga:
Me 31.12.2022 shoqëria "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K., ka aktive afatgjata në vlerë 825.191,760 lekë, të cilat përbëhen nga:
Totali i aktiveve me 31.12.2022 është 967,942,476 (Nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë milion e nëntëqind e dyzet e dy mijë e katerqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë.

Adresa:Rr.Tre Vellezerit Kondi, Vilat Amerikane, ndertesa 736, Tirane ; Cel:+355 69 20 70 654,
www.acamargjeka.com, www.acamargjeka.al e-mail: shkelzenmargjeka@yahoo.com

SHOQËRIA AUDITUESE
*Audit, Consulting*
&
ACA MARGJEKA SH.P.K.
*Accounting Company*

*DETYRIMET DHE KAPITALI I SHOQËRISË*

Me 31.12.2022 detyrime afatshkurtra janë në vlerë 25,067,271 lekë.

Detyrimet afatgjata me date 31.12.2022 janë në vlerë 618,183,334 lekë.

Kapitali dhe rezervat e shoqërisë "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K. me dt.31.12.2022 janë në vlerë 349,759,142 lekë.

Kapitali i regjistruar (kapitali i nënshkruar) me dt.31.12.2022 është 146,780 leke.

Asambleja e ortakeve të shoqërisë ka vendosur që një pjesë të fitimeve të realizuara gjatë vitit 2022 si dhe fitimin e pashperndare t'i rikapitalizoje në Kapitalin i regjistruar dhe rezerva ligjore të shoqërisë.

Kapitali i regjistruar i shoqerise "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K., do të zmadhohet me 186,483,000 (Njëqind e tëtëdhjetë e gjashtë milion e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë) leke, dhe rezervat ligjore me 9,814,720lekë.

- **Kapitali i regjistruar me 31.12.2022 ishte 146,780,000 lekë bëhet 333,263,000 lekë.**
- **Rezerva ligjore ishte 6,681,422 lekë bëhet 16,496,142 lekë.**

Kapitali i përket ortakut të vetem të shoqërisë :

1.Kapitali i shoqërisë është 333,263,000 leke.

2.Numri i kuotave është një i ndarë në:

- ➢ Gert Gjeli një kuote.

3.Pjesëmarrja në kapital është :

- ➢ Gert Gjeli zoteron 1 kuote me 100 % të kapitalit me vlerë 333,263,000 leke.

Arsyeja e Ndryshimit:

Zmadhimi i kapitalit i regjistruar i shoqërisë "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K.,behet permes rikapitalizimin e fitimeve sipas vendimit te të Asamblese së Ortakeve.

Kushtet e ndryshimit :

Për ndryshimin e kapitalit i regjistruar të shoqërisë "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K. Tiranë ,merren parasysh:

Pasqyrat financiare të shoqërisë (Bilanci) me dt.31.12.2022.

Pasqyrat financiare të shoqërisë (Bilanci ) të reformuara me dt.31.12.2022.

Inventaret fizike e kontabël te aktiveve të shoqërisë me date 31.12.2022.

Detyrimet e shoqërise ndaj të tretëve .

**Modalitetet e ndryshimit :**

Veprimet e ndryshimit do të kryhen sipas këtyre modaliteteve:

**1.**Shoqëria do të ruaje formen dhe emrin që ka tani "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K.

**2.**Kapitali i regjistruar i shoqërise do të rritet me fitimet e vitit 2022 si dhe fitimin e mbartur (sipas vendimit ortakut te vetem themelues) .

**3.**Do të bëje korrigjimin e Statutit për pjeset që lidhen me ndryshimin e kapitalit ,si dhe do të kërkojë pranë QKB (QKR), Tiranë për depozitimin e vendimit në Regjistrin Tregtar.

**4.**Në përfundim të këtyre veprimeve pasqyrat financiare (bilanci) të shoqërisë **"Albania Car Rentals" SH.P.K.** do të paraqitet të reformuara sipas modelit bashkengjitur.

**Kapitali i regjistruar i shoqerise** "ALBANIA CAR RENTALS" SH.P.K.**.;**

Kapitali i regjistruar i shoqerise do të zmadhohet me 186,483,000 leke,.

Rezervat ligjore do të rriten me 9,814,720 leke.

Kapitali i regjistruar i shoqërise pas zmadhimit do të jete 333,263,000 (Treqind e tridhjete e tre milion e dyqind e gjashtedhjete e tre mijë) lekë,i cili i përket ortakut të vetem z.Gert Gjeli dhe rezerva ligjore do të jenë 16,496,142 lekë.

SHOQËRIA AUDITUESE
*Audit, Consulting*
&
ACA MARGJEKA SH.P.K.
*Accounting Company*

**Kapitali i përket ortakut të vetem të shoqërisë:**

- **Z.Gert Gjeli ,100% te kapitalit e barabarte me një kuote;**
- **Z.Gert Gjeli zoteron 1(Nje) kuote të barabartë me 333,263,000 lekë;**

**Kapitali i regjistruar llog.101**

| | Debi | Kredi | |
|---|---|---|---|
| 31.12.2022 | | 146,780,000 | T.K. |
| 08.10.2023 | | 186,483,000 | L.K |
| 08.10.2023 | | 333,263,000 | T.K. |

**Rezerva ligjore llog.1071**

| | Debi | Kredi | |
|---|---|---|---|
| 31.12.2022 | | 6,681,422 | T.K. |
| 08.10.2023 | | 9,814,720 | L.K |
| 08.10.2023 | | 16,496,142 | T.K. |

**Fitimi i vitit 2022 llog.109**

| Debi | Kredi | |
|---|---|---|
| | 132,112,740 | 31.12.2022 |
| 132,112,740 | | 08.10.2023 |
| 0 | 0 | 08.10.2023 |

**Fitimi i pashperndare llog.108**

| | Debi | Kredi | |
|---|---|---|---|
| T.K. | | 64,184,980 | 31.12.2022 |
| L.K | 64,184,980 | | 08.10.2023 |
| T.K. | 0 | 0 | 08.10.2023 |

Bashkelidhur raportit jane Pasqyra e pozicionit financiare (Bilanci) dhe pasqyra e levizjes se akiveve dhe pasiveve,te cilat rekordojne me bilancin e shoqerise .
Pra sic shihet edhe nga bilanci dhe llogarit e shoqerise rritja e kapitalit eshte e bazuar ne Legjislacionin ne fuqi dhe mbeshtetet edhe nga aktivet , pasivet dhe kapitali i shoqërisë.

*Mendoj se rritja e kapitalit është e rregullt duke parë vertëtsine dhe sinqeritetin e pasqyrave financiare të audituara nga unë, që i bashkëngjiten këtij raporti,gjithashtu une nuk kam ndonje vërejtje lidhur me paraqitjen e ndikimit të misionit mbi situaten e ortakut, e çmuar në raport me kapitalin,ndaj zmadhimi i kapitalit është në përputhje dhe në zbatim të legjislacionit në fuqi.*

SHOQËRIA AUDITUESE "ACA MARGJEKA" SH.P.K
(Audit, Consulting & Accounting Company)

Partner Angazhimi
Shkelzen MARGJEKA, Auditues Ligjor

Tirane me 08.10.2023

AUDIT-CONSULTING-ACCOUNTING
ACA MARGJEKA sh.p.k.
www.acamargjeka.com
NUIS: L61408003D TIRANE